

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. T., nga fshati Sh., Komuna e K. ku edhe jeton, të cilin sipas autorizimit e mbron avokat V. I., nga Gj., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, - Departamenti për Krimeve të Rënda PP.I. nr. 121/2016, të datës 27.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 14.09.2016, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

I akuzuari Sh. T., nga i ati M., dhe nëna M., e lindur K., i lindur ... në fshati Sh., Komuna e K. ku edhe jeton, i martuar, baba i ... fëmijëve, i pa punësuar, - ..., ka të kryer shkollën e mesme drejtimi ..., i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

Se në kohë të pa vërtetuar më parë, i akuzuari në shtëpinë e tij në fshatin Sh., Komuna e K., pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi fishekë të armës së gjahut, ashtu që sipas urdhëresës së Gjykatës

*UGJK 97/2016 gjatë bastisjes së shtëpisë së të pandehurit më datë ... .2016, janë gjetur dhe sekuestruar ... copë fishekë të kalibrit ... .*

*Me çka ka kryer veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës.*

*Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,46, 69,114,të KPRK-ës, dhe neneve 365, 453 të KPPRK-ës.*

## **E G J Y K O N**

*Të akuzuarin **SH. T.**, me dënim me gjobë në shumë prej 350 (treqind e pesëdhjetë) euro, të cilën gjobë i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën Gjykata do të ia zëvendësoi me dënim burgu ashtu që do të i llogaritet shuma prej 20 (njëzet) euro për një ditë burgimi.*

*Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i municionit – 42 (dyzet e dy) fishekëve të armës së gjuetisë.*

*Obligohet i akuzuari që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 35 (tridhjetë e pesë) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*

## **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I. nr. 121/2016, të datës 27.05.2016, kundër të akuzuarit Sh. T., nga fshati Sh., Komuna e K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit.*

*Prokurori Agron Uka mbeti në tërësi pran aktit akuzues dhe pas pranimi të fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet shtoi se nuk ka vërejtje në pranimin e fajësisë dhe konsiderojmë se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit Sh. T. është edhe në përputhje me provat materiale të propozuara në aktakuzë si dhe në pajtim me nenin 248 të KPPRK-ës, pranimi i fajësisë si i tillë duhet të pranohet. I propozoi gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe i njëjti të dënohet sipas ligjit.*

*Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të akuzuarit Sh. T., avokat V. I., deklaroi se nuk kam vërejtje në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pas ballafaqimit me shkresat e lëndës dhe provave materiale, bërjes me dije lidhur me pasojat dhe përparësitë e pranimi të fajësisë i njëjti është deklarua se e pranon fajësinë vullnetarisht dhe në harmoni me dispozitat e KPPRK. I propozoi Gjykatës që lidhur me lartësinë e dënimit Gjykata të ketë parasysh si rrethana lehtësuese se i akuzuari është njeri familjar, pranimin e fajësisë nga ana e tij, kushtet e rënda ekonomike, propozoi që gjykata mundësisht të i caktoj një dënim sa më të but që është e mundur.*

*I akuzuari Sh. T., deklaroi se unë e pranoi fajësinë për veprën penale që më vihet në barrë sipas aktit akuzues, fajësinë e pranoi pa kurrfarë presioni dhe se jam i njoftuar nga gjykata për pasojat dhe benifitet e pranimi të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëj edhe pas konsultimit me mbrojtësin time avokat V. I..*

*Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si: formularë prone i datë 19.05.2016, foto dokumentacionit si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari Sh. T., në mënyrë të paautorizuar në shkelje të ligjit të zbatueshëm, ka mbajtur në pronësi ... copë fishekë të kalibrit ... , dhe se të njëjtit fishek i janë sekuestruar nga ana e policisë, me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPPRK-ës.*

*Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPPRK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, se është i gjendjes së dobët ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit për veprat penale dhe rrezikshmërinë shoqërore duke qenë se posedimi i armës pa leje paraqet rrezik për popullatën. Në prezencë të rrethanave të shumta lehtësuese e si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, të akuzuarit ju është shqiptuar dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPPRK-ës.*

*Të akuzuarit Sh. T., i është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i ... fishekëve të pushkës së gjuetisë të kalibrit ..., bazuar në nenin 62, 68 dhe 374 par. 3 të KPRK-së.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.*

*Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr. 123/2016 Me datë. 14.09.2016**

**Sekretarja juridike,**  
Naile Neziri

**Kryetari i trupit gjykues**  
Agim Ademi

**KËSHILLA JURIDIKE:** *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.*